20260290418

QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në bazë të nenit 35 të Ligjit për Ekzekutimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2026 („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 253/25), Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në mbledhjen e mbajtur më 10 shkurt 2026, miratoi

PROGRAMI PËR MBËSHTETJEN E SIGURISË SOCIALE TË GRAVE QË USHTROJNË VEPRIMTARI BUJQËSORE PËR VITIN 2026

I

- Me këtë Program do të realizohet masa për mbështetje financiare të grave që ushtrojnë veprimtari bujqësore dhe kanë statusin e të siguruarës si bujq individualë, nëpërmjet mjeteve financiare të pakthyeshme. Nëpërmjet këtij Programi, grave do t'u mundësohet shfrytëzimi i kompensimit për mëmësinë gjatë periudhës së pamundësisë për ushtrimin e veprimtarisë bujqësore për shkak të lindjes, kompensim i cili nuk është i përfshirë në dispozitat ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës në lidhje me pushimin e paguar të lehonisë.

- Mjetet për realizimin e këtij Programi, në shumën e përgjithshme prej 1.000.000,00 denarësh, janë siguruar nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2026 („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 253/25), në ndarjen 14004, nënprogramin 23, zërin 464 – transfere të ndryshme, të cilët do të shfrytëzohen nga Agjencia për Mbështetje Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural (në tekstin e mëtejmë: Agjencia) për mbështetje financiare në shumën prej 100.000,00 denarësh për kompensimin nëntëmujor të mëmësisë për gratë që kanë statusin e të siguruarës si bujq individualë, të fituar në përputhje me Ligjin për Sigurimin Pensional dhe Invalidor.

- Një pjesë e mjeteve nga paragrafi (2) i kësaj pjese, në shumën prej 300.000,00 denarësh, janë të destinuara për shlyerjen e detyrimeve të papaguara nga Programi për Mbështetjen e Sigurisë Sociale të Grave që Ushtrojnë Veprimtari Bujqësore për vitin 2025.

II

Mbështetja financiare nga pjesa I, paragrafi (2), i këtij Programi i ndahet gruas për fëmijën e lindur në periudhën nga data 1.12.2025 deri më 1.12.2026, e cila i plotëson kushtet e mëposhtme:

- Është e regjistruar në Regjistrin e Vetëm të Ekonomive Bujqësore si bartëse ose anëtare e ekonomisë bujqësore familjare;

- Ekonomia bujqësore familjare në të cilën ajo është anëtare ka realizuar mbështetje financiare në përputhje me Programin për Mbështetje Financiare në Bujqësi për vitin 2024, në shumën prej së paku 50.000,00 denarësh, ose ka realizuar të ardhura nga ushtrimi i veprimtarisë bujqësore për vitet 2024 dhe 2025, në shumën prej së paku 150.000,00 denarësh;

- Ka pasur status të pandërprerë të të siguruarës si bujq individuale, në përputhje me Ligjin për Sigurimin Pensional dhe Invalidor, për një periudhë prej gjashtë muajsh para lindjes së fëmijës.

Mbështetja financiare nga paragrafi (1) i kësaj pjese realizohet në bazë të kërkesës së paraqitur pranë Agjencisë, jo më vonë se më 10 dhjetor 2026, së cilës duhet t'i bashkëngjitet dokumentacioni i mëposhtëm:

- Ekstrakti nga libri amë i të lindurve për fëmijën për të cilin kërkohet kompensimi i mëmësisë, ose letra e lëshimit nga institucioni shëndetësor ku është kryer lindja;

- Vërtetim për gjendjen e tatimeve, kontributeve dhe të ardhurave dhe detyrimeve të tjera publike, i lëshuar nga Drejtoria e të Ardhurave Publike pas datës së lindjes së fëmijës;

- Aktvendim nga Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë së Veriut për përcaktimin e statusit të të siguruarës si bujq individuale;

- Vërtetim i lëshuar nga Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut, që dëshmon se nëna nuk ka qenë e punësuar në marrëdhënie të rregullt pune gjatë periudhës prej gjashtë muajsh para lindjes së fëmijës;

- Fotokopje e llogarisë së transaksionit të nënës; dhe

- Deklarata vjetore tatimore për të ardhurat e realizuara për vitet 2024 dhe 2025, e lëshuar nga Drejtoria e të Ardhurave Publike, si dëshmi se ekonomia bujqësore, në të cilën nëna është bartëse ose anëtare e ekonomisë bujqësore familjare, ka realizuar të ardhura nga ushtrimi i veprimtarisë bujqësore në shumën prej së paku 150.000,00 denarësh.

- Dokumentacioni nga paragrafi (2), alineat 1, 2, 3, 4 dhe 6 të kësaj pjese dorëzohet në origjinal ose në fotokopje të vërtetuar nga noteri.

III

Pagesa e mjeteve nga ky Program kryhet nga Agjencia, në bazë të aktvendimit për pagesë të nxjerrë nga drejtori i Agjencisë, jo më vonë se më 25 dhjetor 2026.

IV

Drejtori i Agjencisë, më së voni deri më 31 janar 2027, i dorëzon Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut raport me treguesit financiarë për realizimin e këtij Programi dhe arsyet për devijimet eventuale.

V

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e publikimit të saj në **„Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut"**.

Nr. 57- 634/6

10 Shkurt 2026
Shkup

Kryetar i Komisionit dhe
zëvendëskryetar i Qeverisë së
Republikës së Maqedonisë së Veriut
Ljupço Dimovski, n.p